



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 894/7 Prot.

Tiranë, më 29.01.2016

V E N D I M
Nr. 15, datë 29.01.2016

**Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 894/1 prot., datë 23.12.2015**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me detyrimin për sistemimin në një pozicion të shërbimit civil, si nëpunëse civile në "listë pritje", për rastin e nëpunëses *****,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit të verifikimit nr.894/1 prot., të datës 23.12.2015, pasi shqyrtova informacionin e përcjellë nga punonjësja ***** , regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 894 prot., datë 09.12.2015, vendosa nisjen e verifikimit në lidhje me detyrimin për sistemimin e saj në një pozicion të shërbimit civil, si nëpunëse civile në "listë pritje".

Nga aktet e administruara rezulton se, punonjësja ***** ka filluar punë, me Urdhrin nr.483/1, në datën, 01.02.2007, me akt emërimi, në pozicionin "Sekretare e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme". Më pas, me Urdhrin nr. 832, datë 28.12.2010 të Ministrit të Punëve të Jashtme, ajo ka kaluar në pozicionin "Sekretare në Drejtorinë e Përgjithshme të Çështjeve të Sigurisë dhe Organizatave Ndërkombëtare" (të dy këto pozicione ishin jashtë shërbimit civil). Në vazhdim, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, për

pozicionin “Specialiste në Sektorin e Sekretarisë Qendrore, Ndërlidhjes dhe Shifrës, në Drejtorinë e Arkiv Dokumentacionit”, me shkresën e Departamentit të Administratës Publike, nr.1502/12 prot., datë 24.12.2012, kjo punonjëse është emëruar “nëpunëse civile në periudhë prove”, duke u pranuar në këtë mënyrë në shërbimin civil.

Në vijim konstatoj se, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, nr. 227, datë 02.12.2013 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MPJ”, institucioni është përfshirë në proces ristrukturimi dhe për këtë shkak, në bazë të nenit 23, të ligjit nr. 8549 datë, 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, pikave 7-10, të Vendimit nr. 360, datë 14.07.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për lirim nga shërbimi civil”, (që ishin efektivë në atë kohë) kjo nëpunëse, me aktin nr. 671 datë 31.12.2013, ka kaluar në “listë pritje”.

Mbi këtë bazë kjo nëpunëse, ka përfutur të drejtat e vendit të saj të mëparshëm të punës, duke filluar prej datës 31.12.2013, deri sa t’i ofrohej një vend tjetër, por jo më shumë se një vit. Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur këtë punonjëse në “listë pritje” gjë nga e cila në kuptim të nenit 67, pika 3, të këtij ligji, ka përfutur statusin e nëpunësit civil (pasi kishte më shumë se një vit në këtë vend pune).

Ndërkohë rezulton se, pa u plotësuar afati 1 vjeçar i “listës së pritjes”, në datë 20.10.2014 kjo punonjëse ka filluar lejen e lindjes dhe gjatë kësaj periudhe është trajtuar nga ana financiare, nga fondi i Sigurimeve Shoqërore, në bazë të ligjit nr. 7703, datë 11.06.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në RSH”. Pas përfundimit të lejes së lindjes, me pretendimin se punonjësja vazhonte të ishte në listë pritje, pasi periudha që kishte qenë me leje lindje, kishte ndërprerë afatin 1 vjeçar të listës së pritjes, ajo ka filluar të kërkojë sistemimin në një pozicion pune të shërbimit civil, pikërisht si nëpunëse në listë pritje.

Nga aktet e administruara rezulton se refuzimi i Departamentit të Administratës Publike për ta sistemuar në punë, bërë nëpërmjet shkresës nr. 5511/1, dt. 27.11.2015, është momenti i lindjes së mosmarrëveshjes ndërmjet njësisë përgjegjëse dhe nëpunëses *****, e cila është bërë objekt i shqyrtimit të ligjshmërisë së këtij qëndrimi nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Në rastin konkret në analizë të përmbajtjes së nenit 23 të ligjit nr. 8549 datë, 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikave 7-10, të Vendimit nr. 360, datë 14.07.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për lirim nga shërbimi civil”, rezulton që lista e pritjes është një gjendje e posaçme e nëpunësit civil, e cila përfitohet në kushte të caktuara nga ligji në fjalë dhe që ka në thelbin e vet, përfitimin e gjithë të drejtave të vendit të mëparshëm të punës (si psh., pagesën, sigurimet shoqërore, vjetërsinë në punë, etj.) dhe mundësinë e sistemimit në një pozicion të shërbimit civil pa konkurrim, por me kufizimin që kjo nuk mund të zgjasë më shumë se një vit kalendarik. Pra, në këtë dispozitë është vënë një afat shterues, gjatë të cilit përfitohen të drejtat e vendit të mëparshëm të punës, i cili nuk mund të zgjatet apo të ndërpritet. Ndërprerja e listës së pritjes mund të ndodhte vetëm nëse gjatë periudhës një vjeçare, arrihej sistemimi i nëpunësit, në një pozicion tjetër të përshtatshëm, në shërbimin civil, ose me kërkesën e tij, kur të punësohej në ndonjë vend pune tjetër, qoftë dhe jashtë shërbimit civil.

Nisur nga sa më sipër, arrij në përfundimin se, qëndrimi i mbajtur nga Departamenti i Administratës Publike, në përgjigjen e kthyer me shkresën nr. 6583/1 dt. 12.01.2016, sipas të cilës pezullimi i afatit të listës së pritjes për periudhën e kohëzgjatjes së lejes së lindjes, nuk parashikohet në legjisllacionin për statusin e nëpunësit civil dhe se leja e lindjes nuk mund të ketë efekt mbi gjendjen juridike të punonjësës *****, si nëpunëse civile në listë pritje, deri në përfundim të afatit një vjeçar, vlerësohet i drejtë. Në ligjin nr. 8594, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”, si edhe në aktet nënligjore të tij, nuk ishte parashikuar mundësia e pezullimit të afatit të listës së pritjes, qoftë edhe për shkak të raportit mjekësor, ndërsa ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, nuk e njeh institutin e “*listës së pritjes*”, prandaj pretendimet e nëpunëses në fjalë gjenden të pabazuara në ligj.

Përfundimisht, çmtoj se menaxhimi i këtij rasti nga ana e njësisë përgjegjëse është bërë në përputhje me ligjin, prandaj nuk shihet i nevojshëm investimi apo ndërhyrja, e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në nenin 16, pika 6, dhe 34, pika 2, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me Urdhrin e verifikimit nr.894/1 prot., datë 23.12.2015, “*Për verifikimin e informacionit në lidhje me, detyrimin për sistemimin e punonjësës ***** në një pozicion të shërbimit civil, si nëpunëse civile në “listë pritje”*”.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Ministria e Punëve të Jashme, Departamenti i Administratës Publike si dhe kërkuesja, punonjësja *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA